

RAPORT VJETOR I ETIKËS (RVE)

Viti: 2025

Institucioni: Qendra e Parandalimit të Krimeve Të Të Miturve
dhe të Rinjve

Këshilltari i Etikes:

Data përfundimit: 25/02/2026 /Versioni publik/ i brendshëm

0. Përmbledhje Ekzekutive

Përshkruani shkurt gjetjet kyçe të vitit, tendencat kryesore dhe rekomandimet prioritare (1 faqe).

Gjatë vitit 2025, në Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, nuk janë regjistruar kërkesa për këshillim etik nga punonjësit, çka tregon një nivel të qëndrueshëm të respektimit të standardeve të etikës në institucion.

Në të njëjtën kohë, është evidentuar një rast i vetëm i masës disiplinore, i trajtuar brenda afateve ligjore. Aktivitetet e trajnimit dhe informimit kanë qenë të kufizuara, por kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për normat etike.

Rekomandohet rritja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe trajnimeve për të gjithë punonjësit, si dhe forcimi i mekanizmave të raportimit dhe këshillimit etik.

1. Mandati, Roli dhe Baza Ligjore

Ky raport përgatitet nga Këshilltari i Etikes në zbatim të: Ligjit nr. 9131/2003; VKM nr. 874/2021; si dhe Udhezimit nr. 2, date 21.01.2025 të DAP.

RVE shërben për analize të brendshme vjetore dhe publikohet i anonimizuar. Raportimi periodik ndaj DAP-it kryhet sipas afatit trevjeçar të përcaktuar nga aktet nënligjore.

2. Metodologjia dhe Burimet

Burime:

- Regjistri i kërkesave për këshillim etik për vitin 2025
- Të dhëna nga Komisioni Disiplinor
- Dokumentacioni i trajnimeve dhe aktiviteteve informuese
- Komunikime të brendshme institucionale (e-mail/mbledhje)

3. Këshillimi Etik

3.1 Statistikat vjetore

- Numri total i kërkesave për këshillim etik: **0**. Për pasojë, nuk ka kërkesa të trajtuara brenda apo jashtë afatit ligjor.
- Koha mesatare e përgjigjes: **nuk aplikohet**, për shkak të mungesës së kërkesave.
- Temat më të shpeshta: **nuk aplikohen**, për shkak të mungesës së rasteve të raportuara.

a. Shënime cilësore

Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste konkrete për këshillim etik. Për rrjedhojë, nuk ka çështje tipike apo interpretime të përsëritura për t'u analizuar.

4. Masat Disiplinore (informacion i permbledhur)

Kategoria e shkeljes	Nr. rasteve	% ndaj totalit te nepunesve	Kohezgjatja mesatare e proceseve
Vërejtje	1	7%	8 ditë

Shënim: Të dhënat merren nga komisionet disiplinore; KE raporton vetëm në nivel statistikor.

5. Trajnim dhe Informim

5.1 Aktivitetet e zhvilluara

- Është zhvilluar **1 sesion orientues** për punonjësit e saporekrutuar, me pjesëmarrjen e **1 punonjësi**.
- Është realizuar **1 trajnim fillestar**, me pjesëmarrjen e **1 punonjësi**, që përbën rreth **7%** të numrit total të punonjësve.
- Informimi është kryer nëpërmjet komunikimeve të brendshme, kryesisht përmes e-mailit dhe/ose mbledhjeve të stafit.

5.2 Pjesëmarrja dhe rezultatet

Data	Lloji trajnimit	Pjesemarrës	Rezultat mesatar /Test	Verejtje
05/11/2025	Trajnim fillestar	1	Mesatar	Nuk ka

6. Dhurata dhe Mikpritje

Gjatë vitit 2025 nuk janë raportuar raste të pranimit të dhuratave apo përfitimeve të tjera në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Data pranimit	Marresi	Pershkrimi	Vlera (lek/€)	Vendimi	Shenim

Shënim: Raportimi bëhet vetëm në nivel statistikor duke shmangur të dhënat personale.

7. Veprimtari të Jashtme (me pagesë)

Gjatë vitit 2025 nuk janë paraqitur kërkesa nga punonjësit për ushtrimin e veprimtarive të jashtme me pagesë.

Data kërkesës	Punonjësi (kod/anonim)	Subjekti/Organizata	Lloji aktiviteti	Vendimi (lejohet/kushtezohet/ndalohe t)	Kushtet

8. Kufizimet pas largimit nga detyra.

Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar raste që lidhen me kufizimet pas largimit nga detyra.

Nr. njoftimeve	Raste të ndjeshme (pa identifikim)	Masat e marra

9. Rekomandime SMART për vitin pasardhës

Masa	Përgjegjësi	Afati	Treguesi	Burime (si realizohet)
Rritja e ndërgjegjësimit mbi etikën	Këshilltari i Etikës	2026	Nr. i trajnimeve të zhvilluara	Trajnime / materiale informuese
Organizimi i të paktën 2 rajnimeve	Institucioni	2026	2 trajnime / vit	Burime njerëzore
Krijimi i një mekanizmi të thjeshtuar raportimi	Këshilltari i Etikës+ institucioni	2026	Funksionimi i një kanali raportimi	E-mail institucional

10. Anonimizim dhe Përputhshmeri me Mbrojtjen e të Dhënave

Të gjithë emrat dhe të dhënat personale janë hequr ose zëvendësuar me kode. Raporti respekton ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale; dokumentet mbështetëse ruhen brenda institucionit dhe nuk publikohen.

11. Miratimi dhe Publikimi

Data e miratimit nga Titullari: 30/03/2026

Emri/Nënshkrimi i Titullarit: 


Publikimi i raportit të anonimizuar (pa të dhëna personale): Data: 30/03/2026

A. Aneks - Tabela dhe Grafike

- Tabelat Excel me të dhëna statistikore
- Grafike



Masat Disiplinore



Pjesemarrje ne trajnim te te rinjve te rekrutuar

